

## REVTË E 18-TA RAJONALE TË KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE NË ORGANIZIM TË LSHPM

Takimi në revy ishte me numër të kufizuar të të pranishmëve dhe me respektim të rreptë të masave në lidhje me pandeminë Kovid19, në ambient të hapur, me distancë të nevojshme dhe mjete dezinfektuese, me prezencë të dy motrave medicinale nga Kryqi i Kuq dhe me njek pensionist nga LSHPM

*Shkup, 14 tetor - Më 29 shtator të këtij viti, në Qendrën rekreative Saraj, në organizim të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, u mbajt Revja e 18-të rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve të rajonit të tretë. Nikoqiri i kësaj revye ishte Shoqata e pensionistëve të Komunës së Sarajit. Në të morën pjesë shoqatat e Shkupit, si ajo e Sarajit, Gazi Babës, OVR, Shoqata e pensionistëve të luftës dhe Ilinden. Takimi në revy ishte me numër të kufizuar të të pranishmëve dhe me respektim të rreptë të masave në lidhje me pandeminë Kovid19, në ambient të hapur, me distancë të nevojshme dhe mjete dezinfektuese, me prezencë të dy motrave medicinale nga Kryqi i Kuq dhe me njek pensionist nga LSHPM. Revynë e hapi kryetari i shoqatës nikoqire, Mahir Duraku, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit, ndërsa pastaj fjalimin e tij e mbajti në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe.*

# BASHKËJETESË DHE SHOQËRIM EDHE NË PLANIN MUZIKOR



"Për ne si shoqatë eshtë nder dhe kënaqësi të jemi nikoqir të kësaj revye. Edhe ky eveniment eshtë i një rëndësie, para se gjithash përruajtjen e traditës dhe afritit dhe respektit të ndërsjellë. Kjo eshtë një porosi pozitive edhe përgjenerat e reja. Shprehim falenderim edhe

deri te LSHPM përbesimin e dhënë që shoqata jonë të jetë nikoqir", eshtë shprehur Duraku.

Përfaqësuesi i Komunës së Sarajit, Xhelal Jakupi, në emër të kryetarit të Komunës, në gjuhën maqedonase dhe shqipe përshëndeti të pranishmit dhe u dëshroi qëndrim



të këndshëm, duke theksuar se komuna, në kuadër të mundësive të saja, eshtë e gatshme të ndihmojë pensionistët sepse ata e meritojnë një gjë të tillë. Kryetari i Këshillit ezekutiv të LSHPM, Mentor Qoku e shpalli revynë të hapur, dhe ju drejtua të pranishmëve në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe. "Sot po mbahet Revja e 5-të me radhë e këngëve, muzikës dhe valleve në vitin 2020, në organizim të LSHPM, ndërsa nikoqir i kësaj revye eshtë SHP Saraj. Kjo Shoqatë për herë të parë eshtë nikoqire dhe eshtë munduar që sot të realizojë këtë revy në kushte sa më të mira edhe përkundër pandemisë", eshtë shprehur Qoku.

Në organizim të LSHPM, më 1 tetor të këtij viti, në Qendrën sportive-rekreative Saraj në Shkup, pensionistët e rajonit të katërt jo vetëm që u argëtuan, por edhe në mënyrën më të mirë kanë shfaqur një pjesë të kolorit të tyre burimore folklorik. Sipas rekomandimeve të LSHPM, Revja u mbajt nën qell të hapur në skenë të hapur dhe sipas të gjitha protokolleve.

Në këtë takim, pensionistët pësëmarrës, në mënyrë shumë të suksesshme u prezantuan me këngë burimore, me solistë dhe grupe të këngëtarëve. Këndohej, ndërsa të pranishmit të mahnitur kanë përcjellë shfaqjet e pensionistëve, duke mos kursyer duartrokitjet për

këngët dhe interpretimet e bukura, në të cilat kishin kënaqësinë të t'i dëgjonin përnjë orë e gjysmë. Mysafirët, të pranishmit dhe pjesëmarrësit, i pari i përshëndeti dhe u dëshroi mirëseardhje koordinatori i shoqatës nikoqire, Todor Iliev.

Në fjalën e tij përshëndetëse në gjuhën maqedonase dhe shqipe, kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, theksoi lidhjen tradicionale mes vetëqeverisjes lokale dhe SHP Çair, e cila me aktivitetet kontribuon në përfaqësimin e denjë të komunës. Ai në fjalimin e tij theksoi se SHP Çair bie në mesin e kategorisë më të organizuar të qytetarëve të komunës.

"Kjo për ne eshtë një motiv plus kur e shohim nga ana juaj atë entuziazëm dhe motiv të madh që përtu shoqëruar, të jeni ende aktiv dhe të këmbeni përvojat mes vete. Kjo eshtë një udhërrëfyes për ne gjeneratrat e reja", eshtë shprehur Ganiu.

Në emër të organizatorit, para se të shpallë revynë të hapur, kryetarja e LSHPM Stanka Trajkova, shprehur kënaqësinë e veçantë që SHP Çair eshtë nikoqire e revysë së 18-të rajonale, shoqatë e cila eshtë një prej shoqatave më aktive në Republikë. Ajo gjithashtu theksoi se kjo revy mbahet në shenjë të shënimit të 1 Tetorit, Ditës botërore të personave të moshuar. Nikoqirë të revyve të këtilla rajonale ishin edhe SHP Karposh, SHP Demir Hisar, SHP Llozovë, SHP Veles dhe SHP Makedonska Kamenicë. Shoqërimi gjithkoh ishte sipas protokolleve, me maska dhe në distancë, në hapësirë të hapur dhe me numër të kufizuar të pjesëmarrësve, por me shumë kënaqësi përshkak të mbajtjes së takimeve, të cilat gjithkujt po u mungojnë.

(K.S.A)

## TAKIM ME SABEDIN EJUPIN - SAICON, MUZICIENT DHE PIKTOR

## Një jetë kushtuar muzikës dhe pikturës



E tèrë jeta eshtë një udhëtim. Rrugë jetësore përmes së cilës hapëron secili, e udhëheqë atë pa u varur shumë nga ai. Shumica ndoshta nuk do të ishin pajtuar me atë, duke theksuar shembuj dhe fakte të shumta, megjithatë, rasti me Sabedin Ejupin - Saigon, siç e njohin të gjithë, e vërteton pikërisht atë. Bisedën me të e kemi bërë në mini ateliën e tij, të hapur para 15 viteve në QT Ramstor. Ai ishte i kënaqur që serish do të kujtohet në rininë e tij, kur kishte shumë ditë të bukuria dhe të lumtura.

Që në vitet e fëmijërisë, më saktësish që në ditët e hershme shkollorë, ka ndjerë prirjen e tij përmuzikë dhe pikturë, gjegjësisht në të vizuatuarit e portreteve dhe kërikaturave. Motra e tij ka luajtur në mandolinë në sektionin muzikor të shkollës dhe në mungesë të saj ai ka luajtur në mandolinë dhe në atë mënyrë i ka hyrë në thelb muzikës dhe eshtë dashuruar me të. I blejnë kitarë. Me një shokun e tij ai

formon një grup muzikor të mëhallës dhe organizonte ahengje gjatë asaj kohe. Në shkollë ai të gjithë nxënësve ua bënte vizatimet, dhe pas mbarimit të klasës së tetë, mësimdhënësi ka kërkuar që ai të vazhdojë shkollimin në shkollën e mesme të artit, për të cilën gjë ka kundërshtuar babai i tij.

Ai eshtë i lindur në vitin 1956

në Patishka Rekë të Shkupit, ndërsa familja e tij shpërngulen në Shkup, ku regjistrohet në fakultetin ekonomik, të cilin nuk e kambaruar. Paralelisht ai regjistrohet në Akademinë pedagogjike, drejtimi muzikë dhe mësohet të luajë në piano. Si mësimdhënës i muzikës, punon në disa shkolla të Shkupit. Pasi mbetet pa udhëta-

ren e tij të jetës, e tronditë pikelli mi, por edhe atë goditje Sabedini arrinë ta tejkalojë me një energji edhe më të madhe dhe dashuri më të madhe për jetën. Ai lë punën si mësues i muzikës, merr një pension familjar dhe punon si piktor, por nuk e ka lënë edhe muzikën anash. Ka luajtur në SHKA "Jenioll" dhe "Orhan Veli" në sektionin argëtues, ndërsa në ndërkohe ka kënduar edhe në oktetin "Okarina". Si mësimdhënës ka formuar disa kore dhe orkestra të shkollës, me të cilët ka arritur shumë suksesë dhe ka fituar shumë çmime. Më shumë se 35 vjet, pasioni i tij kryesor eshtë punimi i portreteve dhe karikatureve. Ka punuar në Kroaci, Greqi, Turqi, Shqipëri, Itali.

"Tani, në këto ditët e mia të pensionimit, kohën e lirë ia kushtoj pikture dhe muzikës, të cilat përmua janë dashuria më e madhe. Ajo më relakson dhe më ndihmon që të gjitha problemet t'i kapërcejë më lehtë", eshtë shprehur Sabedini.

Entuziazmi gjithmonë ka qenë primati i tij në jetë, ashtu që në vitin e largët 2008 organizoi eksposítë individuale në galerinë "Toçka", që pasqyron punën e tij shumëvjeçare si piktor. Ai merr pjesë me veprat e tij edhe në shumë eksposita tjera. Por siç thotë vet, ai nuk do të ndalet këtu. Rruga e sukseseve vazhdon me pasqyrimin e tij të piktorit përmes shumë portreteve dhe karikatureve. Ai shpreson se për një kohë shumë të shkurtë do t'u bëjë një befasi shumë të këndshme adhuruese të artit figurativ. Aktivitetet e tij vazhdojnë më tutje edhe si pensionist. Sabedini merr pjesë në grupin muzikor të shqiptareve, udhëheqë edhe me korin edhe në sektionin muzikor pranë SHP Çair, ndërsa një prej detyrave të tij kryesore eshtë që të arrijë sukses sa më të madh me korin e pensionistëve, për të cilin thotë se eshtë i përbërë prej interpretuesve cilësor. (Vasil Paçemski)